

KËRKESË
Nr. 5685/2, datë 24.5.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Jashtme shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurisë së paluajtshme nr. pasurie 3/527, zona kadastrale nr. 8270, truall me sipërfaqe 1511 m², të ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “Donika Kastrioti”, në pronësi të pronarëve Ridvan Ibrahim Resuli, Ingrid Ibrahim Demi, Edvin Ibrahim Resuli, Valbona Mentor Mirakaj.

Vlera e truallit të shpronësuar bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1620, datë 26.11.2008 është 1511 m² x 180.000 lekë për m² = 271, 980,000.

Me anë të këtij njoftimi në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik”, kërkojmë të njoftojmë pronarët dhe personat e tretë të interesuar që preken nga ky shpronësim.

Ky publikim do të publikohet për një periudhë njëjavore. Brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, pronarët apo personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre pranë komisionit të posaçëm për shpronësimet i ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kërkesat duhet të paraqiten të shoqëruara me dokumentet përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik”.

Fatura e shpenzimeve sipas formatit të mësipërm të dërgohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

ZËVENDËSMINISTRE E PUNËVE TË JASHTME
Edith Harxhi